



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
KËSHILLI I FAKULTETIT



Tel/Fax: +355 4 369 987/ëëë.fhf.edu.al

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

Tiranë, më 29.01.2015

VENDIM NR _____

Lënda: Propozime të Këshillit të Fakultetit të Historisë e Filologjisë për projektligjin “PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Këshilli i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, i mbledhur në dt. 29.01.2015, me gjithë kohën e shkurtër të patur në dispozicion, pasi diskutoi e mori parasysh mendimet e sjella me shkrim nga departamentet, vlerësoi disa aspekte të këtij drafti dhe, me synimin e dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e disa problematikave të tij, shprehet si më poshtë:

1. Në këtë draft ka një cënim të autonomisë akademike, organizative, dhe financiare, të garantuara nga Kushtetuta, neni 57/7, e kryesisht në këto nene:

- Neni 3 pika 2,
- neni 7/2, e, 3, a, b,e
- neni 8/3
- neni 14.2
- neni 15/3
- neni 17/6
- neni 18/3,6
- neni 20/3,5
- neni 32/3
- neni 63/1.d dhe 63/3
- neni 64
- neni 68/3

- neni 72/2 dhe 72/5
- neni 78/2
- neni 100/1
- neni 101/1.b dhe 101/3
- neni 112/2

Në mënyrë të përmbledhur Këshilli shprehet se:

a. Pranimet duhet të bëhen nga universitetet. QSHA nuk mund dhe nuk duhet të merret me çështjen e aplikimeve. Universitetet duhet ta kenë si detyrë të tyre të bëjnë publike kriteret e pranimeve dhe nxënësit apo studentët e masterit aplikojnë për t'u pranuar në ciklet e shkollimit. Nga ana e saj QSHA mund të ketë për funksion përpilimin e një database kombëtar me të dhënat e nxënësve që përfundojnë arsimin parauniversitar.

b. Autonomia akademike dhe organizative çënohet përmes këtij modeli të parashikuar për konstituimin e Bordit të Administrimit, i cili përcaktohet si institucioni më i lartë "administrativ" dhe përgjegjës për përmbushjen e misionit të arsimit të lartë në universitet dhe ku në drejtimin e tij, në kushtet e sotme, ka në përbërje një shumicë anëtarësh nga qeveria (4 +3). Ndërkohë që qeveria nuk cakton asnjë anëtar bordi në universitetet private edhe për to destinohen fondet të buxhetit në projektet shkencore. Universitetet kanë lindur dhe funksionuar për shkak dhe falë vizionit akademik dhe jo për shkak të menaxhimit, që do të thotë se organi dhe autoritetit më i lartë në universitet është Senati dhe Rektori. Ky cënim shkon deri aty, kur ky bord propozohet të miratojë edhe statutin e universitetit. Propozojmë që bordi të jetë me shumicë anëtarësh nga universiteti. Gjithashtu, ai duhet të cilësohet vetëm si organi më i lartë administrativ, kurse përgjegjësinë për përmbushjen e misionit të universitetit në arsimin e lartë e ka Senati.

c. Në draft thuhet se shteti vlerëson cilësinë, ndërkohë që cilësia vlerësohet nga agjencia e akreditimit dhe bordi i akreditimit. Agjencia e Akreditimit dhe Këshilli i Akreditimit, si emërtesë dhe funksion janë nën juridiksionin e qeverisë, pra, nuk janë të pavarura sikundër funksionon kudo në botën e sotme universitare. Mund të merret shembull modeli i Kosovës.

d. Cënimi i autonomisë duket edhe në kompetencat që merr Ministri për ta konsideruar Rektorin si vartës të tij, ndërkohë që Rektori është i zgjedhur dhe institucioni i tij është autonom me Kushtetutë. Këtë mbrojtje ia jep kushtetuta nga njëra anë, por është shprehur edhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, e cila në 2007 sanksionoi se Ministri nuk mund të gjykojë veprimtarinë e Rektorit dhe i vetmi ndërmjetës në marrëdhëniet vendimore është gjykata. Pra, Rektori sipas ligjit mund të dekretohet dhe po ashtu të shkarkohet vetëm nga Presidenti i Republikës.

e. Këto dy pushtete midis Senatit dhe Bordit, Rektorit dhe Kryetarit të Bordit, bëhen krejt të paqarta dhe gati janë paralele në njësitë kryesore dhe në njësitë bazë.

2. Ka një burokraci agjencish e strukturash, gati një Ministri e Arsimit të Lartë, të cilat jo vetëm nuk do t'i sjellin të ardhura universitetit, por do t'i marrin edhe të ardhurat që sot ai realizon nëpërmjet shërbimeve që ai kryen vetë. Këto struktura ndërtojnë një sistem burokratik që i zë frymën aspektit akademik dhe ku liria akademike nuk promovohet dhe nuk del e shprehur të mbrohet në këtë draft. Kjo duket qartë se në të gjithë draftin, në qendër janë më shumë këto struktura burokratike sesa studenti dhe profesori, pa të cilët nuk mund të kuptohet funksionimi i sistemit të Arsimit të Lartë. Ky numër i madh agjencish nuk përligjet me shumën e subvencioneve që jep Qeveria nga fondi i pakushtëzuar. Ky fond sot nuk shkon më shumë se 10 muaj paga për pedagogët dhe aspak financim për kërkimin bazë dhe shumë pak financime për projektet. Qeveria duhet domosdoshmërisht të rrisë buxhetin për arsimin e lartë, i cili, edhe këtë vit nuk shkon më shumë se afërsisht 0.6 % e PBB. Atëherë si do të funksionojnë financiarisht këto agjenci, të cilat konvertohen në punonjës, struktura etj?

Shembulli më tipik është megastruktura që quhet QSHA, e cila do të krijojë patjetër konfuzion të pashembullt si edhe mund të kthehet në një burim korrupsioni, pasi i janë lënë 4 funksione shumë të rëndësishme si:

- a.** aplikimet për të gjitha ciklet e studimit, (bachelor, master, master ekzekutiv) përveç doktoraturave dhe specializimeve.
- b.** imatrikullimi dhe database kombëtar i dokumentacionit
- c.** provimet e profesioneve të rregulluara

d. rrjeti kombëtar i internetit.

Kjo strukturë e propozuar është e pangjashme me modelet më të njohura të universiteteve homologe evropiane e më gjerë.

Vetëm i sistemi i masterave të cilët marrin diploma nga pikëpamja e kohës në korrik –vjeshtë (koha e mbrojtjes së provimeve) do të hapë shumë probleme në komunikimin Universitet – QSHA. Mendojmë se QSHA duhet të ketë si funksion :

a. imatrikullimin dhe database kombëtar i dokumentacionit si dhe database për rezultatet e shkollave të mesme.

b. provimet e profesioneve të rregulluara

Aplikimet për të gjitha ciklet e studimit të kryhen pranë universiteteve sipas modelit që aplikohet sot gjithandej. Rrjeti telematik mund t'i kalojë AKKSH-së. Propozojmë gjithashtu që shteti të garantojë me ligj pagën bazë të stafit akademik dhe atij ndihmës të brendshëm.

3. Në draft thuhet se shteti merr përsipër të subvencionojë vetëm ciklin e parë. Por ky kufizim do të sjellë uljen e të ardhurave të universitetit publik si dhe në pamundësinë e familjeve shqiptare për të përballuar kostot e shkollimit. Mendojmë se shteti duhet të ushtrojë funksionin e vet mbi arsimin e lartë publik, sepse edhe masteri është një e mirë publike dhe nuk duhet parë thjesht si një e mirë private. Gjithashtu, shteti përcakton një tavan për tarifën e universiteteve publike dhe nuk bën të njëjtën gjë për universitetet private. Mendojmë se qeveria duhet të përcaktojë një dyshemë, në funksion të të ardhurave të familjeve shqiptare.

4. Nëse ky draft-ligj do të bëhet ligj, atëherë ai do të çënojë gati 40% të profesoriatit të ri, i cili nuk ndihet i promovuar nëpërmjet këtij ligji dhe nga ana tjetër, ai do të kthehet nga një e drejtë e fituar nëpërmjet një kontrate me punëdhënësin me afat të pacaktuar, në një kontratë me afat të caktuar. Të gjithë asistentët në procesin doktorate dhe doktorët që kanë më pak se 3 vite punë do të çënohen në marrëdhënien që kanë vendosur aktualisht me punëdhënësin. Pra, kemi cënim të parimit se *“asnjëherë fuqia prapavepruese e ligjit s’duhet të jetë në dëm të personit”*. Propozojmë që ky përcaktim të hyjë në fuqi vetëm për personelin që vjen pas

miratimit të tij, dhe të mos çënojë stafin akademik pjesë aktuale e organikës së universitetit.

- 5.** Cikli i 3-të i studimeve përfshin, masterin ekzekutiv, doktoraturën specializimin. Ky nuk është kuptimi që ka cikli i 3-të sipas Kartës së Bolonjës ku, siç dihet, në të përfshihet Shkolla Doktorale. Në ligj duhet të thuhet qartë se arsimi i lartë mbështetet mbi Kartën e Bolonjës, sepse Shqipëria është nënshkruese e saj. Propozojmë që Masteri ekzekutiv, i cili përplasat me masterat e tjerë të ciklit të 2-të të titullohet “Diplomë postmaster”, duke ruajtur siç thuhet në ligj, se kush e ka të drejtën ta ndjekë këtë diplomë.
- 6.** Lidhur me menaxhimin e fondeve, në zbatim të parimit të autonomisë financiare duhet:
 - a.** Të bëhet një ndryshim në ligjin e buxhetit, ku universitetet te trajtohet si qeverisja vendore. Pra ato duhet të dalin nga skema e buxhetit me destinacione të përcaktuara.
 - b.** Në skemën e buxhetit të futet zëri i kërkimit shkencor dhe projekte shkencore sepse, nga pikëpamja financiare shpenzimet e fondeve duhet të rakordohen me zërat e buxhetit.
 - c.** Nuk e kuptojmë pse nuk është vënë në draft marrja e kredisë nga IAL, ndërkohë që ka qenë si propozim në draft reformën e AL. Universitetet, sikundër qeverisja vendore duhet të kenë të drejtë të marrin kredi nga bankat për të siguruar një infrastrukturë më të shpejtë dhe ta shlyejnë këtë kredi pak e nga pak me të ardhurat që marrin nga studentët. Sigurisht, si edhe qeverisja vendore, marrja e kredisë do të kryhet në rakordim me Qeverinë.
- 7.** Lidhur me komisionet e kualifikimit shkencor ligji duhet të shprehet qartë se KKSH që ngrihen brenda universiteteve të jenë me ekspertë të fushave të ndryshme dhe se në universitetet e mëdha si ky i Tiranës një komision i vetëm, për shkak të përbërjes heterogjene të strukturave të njësive kryesore, nuk mund të përmbushë misionin e përgjegjshëm akademik për dhënien e titullit.
- 8.** Në fillim të draftit, ku përcaktohet misioni krahas formulimeve të bëra, është harruar një formulim që lidhet me

vetë misionin e shkollës, ku duhet të jenë të përcaktuara vlerat, si: ato të edukimit, atdhedashurisë kombëtare, qytetarisë, demokracisë, humanizmit etj, gjë që mungon në këtë draft.

- 9. Në nenin 101, pikat 1, 2** thuhet: *“Baza kombëtare e të dhënave për kërkimin shkencor administrohet dhe përditësohet prej AKKSh-së dhe përfshin: temat kërkimore të ciklit të tretë në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht”. Kjo pikë e nenit bie në kundërshtim me parimet kushtetuese mbi gjuhën zyrtare në vend dhe me nenin 89 të po këtij projektligji, ku thuhet se “Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë në vend ofrohen në gjuhën shqipe”..*

Gjithashtu, krijimi i një baze të dhënash, duhet parë nëse bie ndesh me ligjin për të drejtën e autorit, ku thuhet për grumbullimin e të gjithë kontributit shkencor të personelit akademik.

- 10.** Sintagma “letra e prioriteteve” është një kalkim që i rri keq gjuhës shqipe. Duhet thënë thjesht “prioritetet” ose “përparësitë” sikundër në mjaft raste drafti i reformës së AL ka nevojë për redaktim gjuhësor e në ndonjë rast edhe për spostim të neneve përkatëse, (neni 7 pika 3), ku brenda kompetencave të ministrit flitet edhe për kompetencat e Rektorit.
- 11.** Si përfundim, drafti duhet të çlirohet nga “Vënia në kontroll” e universiteteve prej shtetit nëpërmjet strukturave të fryra, të cilat i zënë frymën aspektit akademik dhe ndërkohë, përsa i përket anës financiare duket haptazi se shteti nuk tregon kujdesin dhe përgjegjësinë e duhur. Ky këshill propozon që shteti të marrë seriozisht përgjegjësinë e financimit të universiteteve publike duke garantuar me ligj përqindjen e PPB - arsimin në tërësi dhe brenda kësaj PPB përqindjen e AL. Gjithashtu, ky Këshill sugjeron që drafti të mos kalojë në parlament pa marrë parasysh sugjerimet e dhëna nga profesori ynë.

K R Y E T A R I
Shezai RROKAJ